



GRENELLI: KURTI PO GËNJEN SE ËSHTË I AFËRT ME SHBA-në, ISHTË KUNDËR ÇDO IDEJE TË PROPOZUAR NGA AMERIKANËT

FAÇE 4

OPINION

A MUND T'UA KTHEJË EVROPA
BORXHIN SHQIPTARËVE PA
NDIHMËN E SHBA-së? F. 6

Shkruan: Prof. dr.
Fejzulla BERISHA



AKTUALE



KALLAS: NORMALIZIMI I PLOTË,
RRUGA E VETME E KOSOVËS DHE
SERBISË DREJT BE-së F. 3

EKONOMI




TREGU I PËRBASHKËT RAJONAL
ËSHTË NJË RRUGË DREJT
NJË TË ARDHMEJE MË TË MIRË
DHE MË TË SIGURT F. 8

SPORT



TERVELL BECK, MVP I JAVËS NË
SUPERLIGËN E BASKETBOLLIT F. 10



Richard Grenelli, i dërguari
special i ish-presidentit
amerikan Donald Trump, ka
shprehur kritika të ashpra ndaj
kandidatit për kryeministër,
Albin Kurti, duke e quajtur jo të
besueshëm dhe duke hedhur
poshtë pretendimet e tij për

afërsi me ShBA-në. "Ne kemi
nevojë për partnerë të
besueshëm. Qeveria e Kurtit
nuk ishte e tillë as gjatë
mandatit të Trumpit, as gjatë
mandatit të Bidenit. Si
republikanët ashtu edhe
demokratët e kanë kritikuar

vazhdimisht Kurtin për
veprimet e njëanshme që
destabilizojnë rajonin. Po këtë
mendim e kanë edhe BE-ja dhe
NATO-ja. Bashkësia
ndërkombëtare është e
bashkuar kundër Kurtit", ka
shkruar Grenelli

VARROSEN TRE
TË MITURIT QË
VDIQËN PAS
SHEMBJES SË
OBJEKTIT NË
JABLLANICË F. 7



ÇFARË PO NDODH
ME USAID-in? F. 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi paralajmëron amerikanët për ndikimin e tarifave, kërcënon BE-në e Britaninë me luftë tregtare

UASHINGTON, 3 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i ka paralajmëruar amerikanët se mund të përballen me "vuajtje" ekonomike për shkak të tarifave tregtare që sapo i ka vendosur ndaj partnerëve tregtarë të ShBA-së. Ai, gjithashtu, kërcënoi me luftë më të gjerë tregtare, duke përfshirë edhe Bashkimin Evropian (BE) dhe, mbase, edhe Britaninë e Madhe. "A do të ketë vuajtje? Po, mbase (dhe mbase jo!)", shkroi Trumpi më 2 shkurt në platformën e vet sociale në lidhje me ndikimin që mund ta kenë tarifatat te konsumatorët amerikanë. "Megjithatë, do t'ia vlejë barra qiranë", shtoi ai. Trumpi u tha gazetarëve se synon të bisedojë me liderët e Kanadasë dhe Meksikës, më 3 shkurt, në lidhje me tarifatat - të cilat ekspertët thonë se mund ta trazojnë ekonominë botërore. Por, Trumpi nuk tregoi nëse po i rishqyrtonte veprimet e tij. "Nuk pres asgjë shumë dramatike", tha ai. Trumpi tha se tarifatat ndaj

mallrave nga BE-ja do të "vendosen patjetër" dhe se kjo do të ndodhë "shumë shpejt". Ai, po ashtu, la të kuptohet se edhe Britania e Madhe mund të përballen me tarifa. BE-ja tha më 2 shkurt se do të kundërpërgjigjej "fuqishëm" nëse Trumpi vendos tarifa, pavarësisht se shpreson të shmangë një luftë tregtare nëpërmjet bisedimeve. "Bashkimi Evropian shpreh keqardhje për vendimin e ShBA-së për të vendosur tarifa ndaj Kanadasë, Meksikës dhe Kinës", tha një zëdhënës i Komisionit Evropian. Vendet e prekura - Kanadaja, Meksika dhe Kina - kanë kërcënuar se do të ndërmarrin veprime hakmarrëse, derisa kanë bërë thirrje edhe për bisedime tregtare në vend të tarifave, të cilat mund t'i rrisin çmimet për konsumatorët dhe t'i dëmtojnë ekonominë e të gjitha palëve të përfshira. Trumpi tha se ai i vendosi këto tarifa ndaj fqinjëve të ShBA-së derisa të ndalet fluksi i emigrantëve dhe i fentanilit të paligjshëm në Shtetet e



Bashkuara, megjithëse shkaktari i këtyre çështjeve është shumë i diskutueshëm dhe përfshin një sërë faktorësh të ndërlikuar. Ai, gjithashtu, ka thënë se këto tarifa do të ndihmojnë në uljen e deficitit tregtar me partnerët kryesorë dhe do ta nxisin prodhimin industrial në ShBA. Trumpi e bëri me dije premtimin e kamotshëm ekonomik më 1 shkurt, duke thënë se Uashingtoni do t'i godasë Kanadanë dhe Meksikën me tarifa prej 25-përqindësh për të gjitha

mallrat, megjithëse produktet energjetike kanadeze do të përballen me një tarifë prej 10-përqindësh. Tarifatat e reja përfshijnë një taksë prej 10-përqindësh për mallrat nga Kina, përveç atyre të vendosura më parë. Trumpi tha se tarifatat për mallrat nga të tri vendet do të hyjnë në fuqi më 4 shkurt. Ai nuk i kushtoi rëndësi kërcënimit të Kanadasë për veprime hakmarrëse, duke thënë: "Nëse duan ta luajnë lojën, nuk e kam telash. Mund ta luajmë lojën sa të duan ata".

Trumpi shkroi se, pa tregtinë me ShBA-në, "Kanadaja nuk do të jetë vend i qëndrueshëm. E vrazhdët, por e vërtetë! Prandaj, Kanadaja duhet të bëhet shteti ynë i dashur i 51-të. Taksa shumë më të ulëta dhe mbrojtje shumë më e mirë ushtarake për popullin e Kanadasë - DHE ASNJË TARIFË!". Kryeministri kanadez Justin Trudeau tha se tarifatat hakmarrëse ndaj importeve nga Shtetet e Bashkuara do të hyjnë në fuqi më 4 shkurt. Trudeau ka njoftuar synimin për t'u larguar nga posti i kryeministrit, dhe partia e tij Liberale do ta zgjedhë liderin e ri më 9 mars. Zgjedhjet pritet të mbahen në pranverë. Kanadaja synon të vendosë tarifa prej 25-përqindësh ndaj importeve nga ShBA-ja, duke përfshirë pijet, produktet kozmetike dhe letrën. Presidentja meksikane Claudia Sheinbaum tha se do të japë hollësi mbi përgjigjen e vendit të saj më 3 shkurt. Edhe Kina ka thënë se do t'i kundërpërgjigjet Trumpit.

Policia maqedonase sekuestron mbi gjysmë milioni euro, arreston 10 persona

SHKUP, 3 SHKURT - Prokuroria për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Maqedoninë e Veriut ka bërë me dije se ka zbuluar dhe konfiskuar rreth gjysmë milioni euro, përfshirë pajisje për numërimin dhe falsifikimin e parave, kopje të pjesëve të kartëmonedhave, si dhe armë dhe municione, gjatë një aksioni të zhvilluar të hënën.

Në një komunikatë për medie, Prokuroria bëri me dije se aksioni, i koduar "Vardar", ka rezultuar me arrestimin e dhjetë personave, ndërsa është realizuar në bashkëpunim me Agjencinë Evropiane të Policisë (EUROPOL), me mbështetjen e Eurojust-it - Agjencisë së BE-së për Bashkëpunim Gjyqësor në Çështjet Penale - si dhe disa



institucione hetimore serbe. "EUROPOL dhe Projekti i EUROJUST për drejtësinë penale në Ballkanin Perëndimor mundësuan koordinimin operacional, analizën kritike të inteligjencës dhe ndihmën teknike për

realizimin e operacionit", thuhet në njoftimin e Prokurorisë. Gjatë kontrolleve autoritetet sekuestruan rreth 500 000 euro, 25 000 dollarë amerikanë, 500 franga zvicerane, 1 800 shekela izraelite, 500 kuna kroate, 10

000 lekë, 1 000 krona suedeze dhe 25 000 rubla ruse. "Janë ekzekutuar 23 urdhra për kontroll në persona dhe banesa dhe janë siguruar prova materiale", njoftoi prokuroria. Sipas prokurorisë, ky aksion është vazhdimësi e operacionit të gushtit të vitit të kaluar, kur autoritetet në Shkup, në koordinim me Prokurorinë Speciale të Kosovës dhe me mbështetjen e Eurojust-it dhe EUROPOL-it, sekuestruan pajisje për falsifikim të monedhave euro, të gatshme dhe gjysmë të gatshme, kallëpe dhe materiale të tjera për prodhim. Në atë operacion një zyrtar policor nga Maqedonia e Veriut u arrestua në Kosovë, nën dyshimin se kishte prodhuar rreth dy milionë monedha

false prej dy eurosh. Ai ishte pjesë e Departamentit për Luftën Kundër Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar në policinë maqedonase. Burime nga hetimet thanë për Radion Evropa e Lirë se i arrestuari ishte pjesë e rrjetit të falsifikatorëve, por jo organizatori kryesor i operacionit. Prokuroria ka njoftuar edhe për zhvillimin dhe rezultatet e pjesës së operacionit të kryer në Serbi. "Në Republikën e Serbisë janë bërë bastisje në disa lokacione, në Novi Pazar, Novi Sad, Sombor dhe Suboticë. Janë arrestuar gjashtë anëtarë të grupit kriminal, dhe janë sekuestruar 180 000 kartëmonedha të falsifikuara në euro", njoftoi prokuroria.

BE-ja: Asnjëra palë nuk fiton nga një luftë tregtare transatlantike

BRUKSEL, 3 SHKURT - Udhëheqësit e Bashkimit Evropian janë mbledhur të hënën në Bruksel për bisedime jozyrtare të përqendruara kryesisht në lidhjet mes bllokut dhe Shteteve të Bashkuara, shpenzimet ushtarake dhe rritjen e industrisë së mbrojtjes të Evropës. Një

pjesë e vëmendjes iu kushtua deklaratave të presidentit amerikan Donald Trump për vendosjen e tarifave ndaj bllokut. Udhëheqësit e vendeve anëtare dhe zyrtarë të lartë të bllokut thanë se nuk do të kishte fitues në një luftë tregtare me Shtetet e Bashkuara. Shefja e politikës së jashtme e

Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, theksoi se tarifatat amerikane do të ndikojnë në vendet e punës dhe çmimet, duke shtuar se Kina do të ishte e vetmja që do të përfitonte nga një situatë e tillë. "Ne jemi shumë të ndërlidhur. Ne kemi nevojë për Amerikën dhe Amerika ka nevojë për ne, gjithashtu", tha ajo, duke folur

para një takimi joformal të udhëheqësve të Bashkimit Evropian në Bruksel. Presidenti Trump i ka paralajmëruar 27 vendet e Bashkimit Evropian se janë në radhë pas vendimit të tij për të vendosur tarifa gjithëpërfshirëse ndaj Meksikës, Kanadasë dhe Kinës.



Grenelli: Kurti po gënjen se është i afërt me ShBA-në, ishte kundër çdo ideje të propozuar nga amerikanët

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 SHKURT - Richard Grenell, i dërguari special i ish-presidentit amerikan Donald Trump, ka shprehur kritika të ashpra ndaj kandidatit për kryeministër, Albin Kurti, duke e quajtur jo të besueshëm dhe duke hedhur poshtë pretendimet e tij për afërsi me ShBA-në.

Në prag të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, Grenelli iu drejtua qytetarëve të Kosovës përmes platformës "X", duke thënë se Kurti po mashtron publikun. "Administrata Trump ka punuar dhe do të vazhdojë të punojë për paqe në Ballkan, por ne kemi nevojë për partnerë të besueshëm. Qeveria e Kurtit nuk ishte e tillë as gjatë mandatit të Trumpit, as gjatë mandatit të Bidenit. Si republikanët ashtu edhe demokratët e kanë kritikuar vazhdimisht Kurtin për veprimet e tij të njëanshme që destabilizojnë rajonin. Po këtë mendim e kanë edhe BE-ja dhe NATO-ja. Bashkësia ndërkombëtare është e bashkuar kundër Kurtit", ka shkruar Grenell.

Ai vuri në dukje se kompanitë amerikane po investojnë në Shqipëri dhe Serbi, por po anashkalojnë Kosovën për shkak të politikave të Kurtit. "Kurti ka qenë kundër çdo ideje të propozuar nga ShBA-ja, pavarësisht nëse ka qenë në pushtet Clintoni, Bushi, Obama,


Bideni apo Trumpi", shtoi Grenelli, duke shtuar se: "Retorika e Kurtit tani, duke pretenduar se është i afërt me ShBA-në dhe se qeveria e tij është më e mirë se të gjitha qeveritë e tjera të Kosovës, është absolutisht e rreme. Mos u mashtroni", përfundoi ai.

Këto deklarata vijnë në një moment kritik të fushatës zgjedhore, duke nxitur debate të reja rreth politikave ndërkombëtare të Kurtit dhe marrëdhënieve të Kosovës me ShBA-në.

Grenelli, i cili ka luajtur rol kyç në marrëdhëniet e ShBA-së me Ballkanin, vazhdon të jetë një zë i fuqishëm në diskutimet për të ardhmen e rajonit.

Ramadani: Deklarata e Grenellit, alarm për Kosovën dhe për sigurinë tonë kombëtare

Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës dhe ish-inspektori i përgjithshëm i AKI-së, Burim Ramadani, deklaraten e Grenellit e ka cilësuar alarm për sigurinë kombëtare. "Kjo fjalë e Richard Grenellit, një nga njerëzit më të afërt të presidentit atipil amerikan Donald Trump, është alarm për sigurinë tonë kombëtare. 'Mos u mashtroni',



thotë Grenell, duke e komentuar absolutisht të rrejshme deklaraten e kryeministrit Kurti se 'raportet e

Kosovës me ShBA-në janë më të mirat ndonjëherë'. Alarm për Kosovën, për sigurinë tonë

kombëtare. Si mund të ketë deklaratë më direkte?", ka shkruar Ramadani në "Facebook".

Kallas: Normalizimi i plotë, rruga e vetme e Kosovës dhe Serbisë drejt BE-së

PRISHTINË, 3 SHKURT - Shefja e diplomacisë të Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, tha se normalizimi i plotë i raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë është "rruga e vetme" që këto shtete t'i bashkohen bllokut.

Në "X", Kallas, e cila është ndërmjetëse e dialogut, ka mirëpritur emërimin e Peter Sorensenit në postin e të dërguarit të posaçëm të bllokut për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Edhe në të kaluarën BE-ja ka thënë se rruga e palëve drejt

bllokut është e kushtëzuar me normalizimin e raporteve.

Sorenseni e ka nisur mandatin e tij më 1 shkurt, pasi mori konfirmimin nga ministrat e Jashtëm të BE-së dhe ambasadorët. Ai në këtë post do ta zëvendësojë Miroslav Lajçakun. "Faleminderit Miroslav Lajçak për përpjekjet tuaja! Puna e bërë do të shërbejë si bazë për riangazhim", ka shkruar Kallas.

Diplomatat nga Danimarka, Sorensen, do të merret vetëm me dialogun në mes të



Kosovës dhe Serbisë e jo edhe me çështje rajonale të

Ballkanit sikurse paraardhësi i tij.

Procesi i dialogut ka nisur më 2011 dhe synon normalizimin e plotë të raporteve. Kosova kërkon që një marrëveshje përfundimtare të përfshijë njohje reciproke, ndërkajshërisht Serbia kërkon një kompromis ku asnjëra palë nuk do të ishte fituese absolute apo humbëse absolute.

Gjatë mandatit pesëvjeçar të Lajçakut palët kanë arritur Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve. Marrëveshja prej 11 nenesh,

ndër të tjera, parasheh një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, që Serbia të mos bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, dhe kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut. Marrëveshja, që ende nuk ka nisur të zbatohet, nuk është nënshkruar, por BE-ja ka thënë se është obligative për Kosovën dhe Serbinë.

Ushtarët e Kosovës trajnohen për përdorimin e 'HAR-66'

PRISHTINË, 3 SHKURT - Në kuadër të bashkëpunimit mes Forcave të Armatosura Turke dhe Forcës të Sigurisë së Kosovës është realizuar me sukses trajnimi për pajisjen HAR-66. Ky trajnim është realizuar në dy regjimentet e Forcave

Tokësore me qëllim të rritjes së kapaciteteve luftarake dhe përgatitjes profesionale të pjesëtarëve të FSK-së. Bashkëpunimi i vazhdueshëm mes dy forcave kontribuon në avancimin e aftësive operacionale dhe forcimin e

partneritetit strategjik ndërmjet dy vendeve.

Forca e Sigurisë së Kosovës mbetet e përkushtuar në zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të saj, për të qenë gjithnjë e më e gatshme për ta përbushur misionin dhe detyrat e saj.





Çfarë po ndodh me USAID-in?

Administrata e presidentit amerikan Donald Trump duket se po mbyll agjencinë kryesore të Uashingtonit për ndihmë ndërkombëtare në kuadër të një morie masash për shkurtime të shpenzimeve qeveritare

PRISHTINË, 3 SHKURT - Administrata e presidentit amerikan Donald Trump duket se po mbyll agjencinë kryesore të Uashingtonit për ndihmë ndërkombëtare në kuadër të një morie masash për shkurtime të shpenzimeve qeveritare. Organizatat humanitare ndërkombëtare kanë paralajmëruar se një vendim i tillë mund të ketë pasoja të mëdha. Në krye të nismës për mbylljen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) është Elon Musk, i emëruari i Trumpit për ulje të shpenzimeve qeveritare. Musk pretendon se administrata mund t'i ulë shpenzimet për 1 trilion dollarë, dhe gjithë lëvizjen e tij e përshkruan si betejë kundër korrupsionit. Punëtorët e USAID-it kanë pranuar një njoftim se selia e agjencisë në Uashington do të jetë e mbyllur për personelin, më 3 shkurt, "me vendim të udhëheqjes së agjencisë", kanë raportuar mediet amerikane CNN dhe Associated Press, duke cituar disa burime të

veta. Radio Evropa e Lirë e ka kontaktuar Ambasadën Amerikane në Prishtinë për të kuptuar nëse një kërkesë e njëjtë i është bërë edhe stafit të USAID-it në Prishtinë, por nuk ka marrë përgjigje deri në publikimin e tekstit. Uebfaqja kryesore e USAID-it, agjenci që, sipas të dhënave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ofron më shumë se 40 për qind të të gjithë ndihmës humanitare në botë, ka qenë jashtë funksionit, ndërsa vetë Trumpi ka pretenduar se agjencia është "udhëhequr prej një grupi të çmendurish radikalë". "Jemi duke i larguar ata dhe do të marrim një vendim për të ardhmen e USAID-it", u ka thënë ai gazetarëve më 2 shkurt. Komentet e Trumpit pasojnë raportimet e medieve, si CNN dhe Reuters, se dy zyrtarë të lartë të sigurisë së USAID-it janë pushuar përkohësisht nga puna, pasi kanë tentuar t'i parandalojnë përfaqësuesit e Departamentit për Efikasitet Qeveritar (DOGE) që të kenë qasje në sistemet kompjuterike të agjencisë.

DOGE është organizatë e themeluar nga Trumpi dhe e udhëhequr nga Musk. Vetë Musk e ka përshkruar USAID-in si "organizatë kriminale", dhe ka thënë se është "koha që ajo të shuhet", ndonëse agjencia menaxhon dhjetëra miliarda dollarë që miraton Kongresi amerikan si ndihmë jashtë kufijve të ShBA-së. Një grup i demokratëve në Komitetin e Senatit për Marrëdhënie me Jashtë i ka dërguar më 2 shkurt një letër Sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio, duke shprehur "shqetësim të thellë" lidhur me veprimet e administratës Trump, e cila është duke shënuar një agjenci që, sipas tyre, është themeluar "për të garantuar që mund të dërgojmë ekspertizë zhvillimore dhe ndihmë përtej kufijve shpejt, sidomos në periudha krizash, për t'i arritur synimet tona për siguri kombëtare". Departamenti amerikan i Shtetit, nën udhëheqjen e Rubios ka marrë vendim, më 24 janar, për t'i ngrirë frondet e reja për pothuajse të gjitha programet për asistencë të huaj, në kuadër të zotimeve të Trumpit për të pasur çdo program në linjë me politikën e tij të jashtme. Rubio, pasi ka marrë detyrën muajin e kaluar, ka thënë se "çdo dollar që shpenzojmë, çdo program që financojmë,

dhe çdo politikë që ndjekim, duhet të justifikohet me përgjigje ndaj tri pyetjeve të thjeshta: A e bën Amerikën më të sigurt? A e bën Amerikën më të fortë? A e bën Amerikën më të begatë?". Në urdhrin ekzekutiv të Trumpit është bërë thirrje për pauzë 90-ditore në gjithë ndihmën, me qëllim të vlerësimit të efikasitetit dhe "konsistencës që ka ndihma me politikën e jashtme amerikane". Urdhri, megjithatë, i mundëson Rubios që të bëjë përjashtime të vogla për "programe specifike". Grupet humanitare dhe organizatat joqeveritare në gjithë botën kanë ngritur shqetësime për fatin e USAID-it, pas urdhrit ekzekutiv të Trumpit.

Ndikimi në Kosovë

USAID-i është i pranishëm në Kosovë prej vitit 1999, dhe prej atëherë ka investuar më shumë se 1 miliard dollarë në zhvillimin e Kosovës. Përgjatë 25 vjetëve USAID-i ka zhvilluar programe për luftën kundër korrupsionit, sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë, luftën kundër dezinformimit dhe avokimin e medieve të pavarura, forcimin e shoqërisë civile dhe demokracisë, zhvillimin ekonomik dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Në gusht të vitit 2024 presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pati nënshkruar një grant me USAID-in, i cili ofron ndihmë shtesë për institucionet e Kosovës në vlerë prej 34.5 milionë dollarësh. Granti ishte pjesë e marrëveshjes së arritur më parë në vlerë rreth 146 milionë dollarë, që synon ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët, rritjen e përgjegjësisë së institucioneve dhe menaxhimin më efikas. Deri para ngrirjes së fondeve, USAID-i në Kosovë ka qenë duke financuar një mori aktivitete. Aty përfshihen: ndihma mbi 12 milionë dollarëshe për mbështetjen e reformave legislative dhe ngritjen e Gjykatës Komerciale; ndihma 15 milionë dollarëshe për ta përmirësuar gjithëpërfshirjen dhe llogaridhënien në qeverisje; ndihma mbi 13 milionë dollarëshe për t'i adresuar sfidat e korrupsionit dhe qeverisjes së mirë në komuna; ndihma gati 12 milionë dollarëshe për përmirësimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe priorizimit të nevojave të qytetarëve gjatë proceseve gjyqësore; ndihma mbi 16 milionë dollarëshe për ta promovuar konkurrencën e mirë në tregjet vendore dhe ndërkombëtare; ndihma mbi 13 milionë dollarëshe për pjesëmarrjen e qytetarëve në

Stavileci: Qytetarët po e mbështesin fuqishëm vizionin për një Kosovë ma të mirë

PRISHTINË, 3 SHKURT - Zëdhënësi i Partisë Demokratike të Kosovës, Blerand Stavileci, ka njoftuar se deri më tani PDK-ja ka zhvilluar mbi 2 000 takime anekënd Kosovës.

Stavileci në një konferencë për medie tha se në çdo qytet, në çdo fshat, në çdo lagje e në secilin takim, vërehet bashkim qytetar për një Kosovë më të mirë. “Qytetarët duan punë dhe rezultate. Zotime të qëndrueshme dhe vepra konkrete. Ata e dinë kush është Bedri Hamza. Fjala e tij për ta ka peshë, sepse çdo premtim që ai bën është një angazhim që e çon deri në fund. Është një garanci ligjore dhe morale. E kanë parë në punë, e kanë parë të ndërtojë, të zhvillojë, të transformojë. Prandaj, qytetarët sot po e mbështesin fuqishëm vizionin për një Kosovë ma të mirë”, theksoi ai.

Sipas Stavilecit, numrat e PDK-së po rriten çdo ditë si rezultat i mobilizimit për rikthimin e madh. “Ky është rezultati i një ekipi të jashtëzakonshëm i kryetarit Memli Krasniqi, i kryesisë, i kandidatëve tanë për deputetë dhe, mbi të gjitha, i kandidatit tonë për kryeministër, Bedri Hamza, një njeri që e mban fjalën dhe që punës i çon deri në fund”, theksoi ai.

Stavileci tha se Kosova ka nevojë për ekonomi të fortë, për arsimim më të mirë, për shëndetësi më të mirë, për siguri e për drejtësi, për institucione që punojnë për qytetarët dhe PDK do ta bëjë këtë vizion realitet. “Në këtë



frymë kemi një mesazh të qartë për qytetarët e Kosovës: Nuk jemi këtu për të përçarë, por për të bashkuar! Nuk jemi këtu për të premtuar, por për të realizuar! Nuk jemi këtu për një fitore të thjeshtë, por për një të

ardhme ma të mirë për Kosovën!”, shtoi ai.

Stavileci tha se 9 shkurti nuk është dita e një vendimi historik mes stagnimit e zhvillimit, mes fjalëve të thata e rezultateve konkrete, mes frikës

e shpresës. “9 shkurti do të flasë ashtu siç po flasin mendjet dhe zemrat e qytetarëve që duan Ma Mirë. Dhe ai rezultat do të jetë i madh, i fuqishëm dhe i pamohueshëm. Ky rezultat do të jetë fillimi i një epoke të re -

për një Kosovë ma të fortë, ma të bashkuar dhe ma të zhvilluar! Për një Kosovë që mundet dhe do të bëjë ‘Ma Mirë’ me Bedri Hamzën Kryeministër!”, përfundoi Stavileci.

qeverisjen lokale; ndihma gati 12 milionë dollarëshe për t'i rritur kapacitetet institucionale për zhvillimin e tregut të energjisë.

Kreshnik Shehu, një përpunues i drurit në Kosovë, i ka thënë ditë më parë Radios Evropa e Lirë se ndihma e ShBA-së ka luajtur rol të rëndësishëm në rritjen e eksporteve të kësaj lënde.

Kompania e Shehut, ashtu si edhe sektori i drurit në përgjithësi në Kosovë, kanë përfituar nga financimet e USAID-it. “Në vitin 2014 eksportet në sektorin tonë ishin 2.5 milionë euro”, ka thënë Shehu për Radion Evropa e Lirë. “Sot ato janë më shumë se 150 milionë euro. Kjo tregon se gjatë dhjetë vjetëve të fundit, kontributi i USAID-it ka qenë shumë i madh. Ai ka qenë një faktor vendimtar për rritjen e këtij sektori”, ka shtuar Shehu. “Nëse ajo ndihmë nuk do të ekzistonte, do të kishim mbetur shumë vite prapa”, ka thënë Shehu, kompania e të cilit e ka selinë në qytetin e

Drenasit. “Ne ende kemi nevojë për të, sepse ende nuk jemi rritur sa duhet për ta përballuar konkurrencën e pabesueshme në tregun ndërkombëtar”.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, pati thënë se USAID-i ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e shtetit të Kosovës. “USAID-i vazhdon të ndihmojë shoqata dhe biznese të shumta, përfshirë ndërmarrje të udhëhequra nga gratë, kompani të teknologjisë informative dhe biznese të orientuara nga eksporti”, ka thënë Rafuna për Radion Evropa e Lirë.

Sipas tij, USAID-i ka ndihmuar edhe në uljen e tensioneve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. “Ka qenë i rëndësishëm në ofrimin e ndihmës për gjetjen e zgjidhjeve për mosmarrëveshjet tregtare, që përfshinin eksportet dhe importet në tregjet serbe dhe rajonale. Pra, përveç nxitjes së zhvillimit ekonomik, USAID-i ka luajtur një rol jetik në uljen e tensioneve mes dy vendeve”.

Ndikimi nga Ukraina deri në Afganistan

Pauza në fondet për Afganistanin “do të ishte katastrofike për më shumë se 22 milionë afganë që kanë nevojë për ndihmë”, ka thënë Jan Egeland, sekretar i përgjithshëm i Këshillit Norvegjez për Refugjatët, në disa përgjigje për Radion Azadi të Radios Evropa e Lirë. Prej kur Rusia e ka nisur luftën e plotë në Ukrainë, në shkurt të vitit 2022, USAID-i i ka ofruar Ukrainës ndihmë në vlerë në miliarda dollarëve, asistencë për zhvillim dhe mbështetje buxhetore.

Trumpi e ka kritikuar sasinë e ndihmës së ofruar - përfshirë miliarda dollarë ndihmë ushtarake - të cilën e ka miratuar Bideni për Ukrainën. Svitlana Musiak, hulumtuese në Komisionin e Pavarur Kundër Korrupsionit, organizatë joqeveritare me bazë në Kiev, ka thënë për Shërbimin ukrainas të Radios Evropa e Lirë se pezullimi i fondeve të USAID-it

për Ukrainën mund të ndikojë negativisht në programet që prekin shoqërinë civile dhe të sinjalizojë “mbështetje të zvogëluar amerikane për reformat demokratike dhe stabilitetin ekonomik të shtetit”. Disa përfaqësues të shoqërisë civile ukrainase kanë thënë se mbështesin një auditim të fondeve që ndan USAID-i në këtë shtet.

Olena Trehub, udhëheqëse e Komisionit të Pavarur kundër Korrupsionit, dhe anëtare e Këshillit kundër Korrupsionit, që funksionon në kundërt të Ministrisë ukrainase të Mbrojtjes, ka thënë më 2 shkurt në “Facebook”, se ajo e ka thënë gjithmonë zëshëm se USAID-i ka nevojë të reformohet, duke thënë se ka qenë dëshmitare e ndarjes së fondeve të mëdha qeveritare përmes kësaj agjencie, por që “rezultatet kanë lënë për të dëshiruar”. Megjithatë, ajo ka përmendur se USAID-i ka mbështetur reforma të rëndësishme, shoqërinë civile, dhe projektet humanitare e infrastrukturore, që kanë pasur ndikim të madh

në zhvillimin e Ukrainës.

Duke folur për kanalin CBS News më 2 shkurt, kongresisti republikan Brian Mast nga Florida ka thënë se është duke punuar me Rubion “për t'u siguruar që ekziston komanda dhe kontrolli i duhur” në agjencitë sikurse USAID-i.

Mast, udhëheqës i Komitetit për Punë të Jashtme i Dhomës së Përfaqësuesve, ka thënë se do ta mbështeste “shuarjen e USAID-it si departament i ndarë” dhe përfshirjen e tij në “departamente të tjera” të Departamentit amerikan të Shtetit.

Dy demokratë të Senatit amerikan kanë thënë në letrën e dërguar më 2 shkurt te Rubio se “secila përpjekje për ta shkrirë apo përfshirë USAID-in brenda Departamentit të Shtetit duhet të bëhet me ligj, dhe duhet të rishikohet, diskutohet dhe miratohet nga Kongresi”. “Kongresi e ka bërë të qartë që secila përpjekje për të riorganizuar apo ridizajnuar USAID-in kërkon konsultim paraprak dhe njoftim të Kongresit”, kanë thënë ata.

A mund t'ua kthejë Evropa borxhin shqiptarëve pa ndihmën e ShBA-së?



Shkruan: Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

Çështja shqiptare është një nga më të ndërlikuarat në historinë evropiane. Fuqitë e mëdha evropiane jo vetëm që kanë ndikuar në copëtimin e trojeve shqiptare, por gjithashtu kanë pasur një rol kyç në trajtimin e padrejtësive historike që lidhen me shqiptarët. Pavarësisht kësaj, një pyetje kyçe mbetet: A mund ta kthejë Evropa këtë borxh pa ndihmën e ShBA-së? Për ta analizuar këtë pyetje, duhet të shqyrtojmë aspektin historik, diplomatik, politik dhe gjeostrategjik, të gjitha të ilustruara me raste konkrete.

1. PSE EVROPA U KA NJË BORXH HISTORIK SHQIPTARËVE?

1.1. Kongresi i Berlinit (1878) - Fillimi i Padrejtësive Ndaj Shqiptarëve.
Kongresi i Berlinit (1878) u organizua nga fuqitë evropiane pas luftërave ruso-turke për të

rishikuar balancat e pushtetit në Ballkan. Shqiptarët, të cilët ende ishin nën Perandorinë Osmane, kërkuar njohjen e një vilajeti autonom shqiptar përmes Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Megjithatë: Evropa shpërfilli kërkesat e shqiptarëve, duke i trajtuar ata si të padukshëm. Trojet shqiptare iu dhanë Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë, pa marrë parasysh vullnetin e popullit. Shqiptarët u detyruan të luftonin për të mbrojtur Plavën, Gucinë, Hotin, Grudën dhe Ulqinin, por Evropa nuk e ndryshoi vendimin e saj. Pasoje afatgjatë: Kongresi i Berlinit vendosi precedent për copëtimin e mëvonshëm të trojeve shqiptare dhe shpërfilljen e interesave të tyre nga fuqitë evropiane.

1.2. Konferenca e Londrës (1913) - Copëtimi i Shqipërisë.

Pas shpalljes së pavarësisë më 28 nëntor 1912, fuqitë e mëdha evropiane e detyruan Shqipërinë të lëshonte më shumë se gjysmën e trojeve të saj në favor të fqinjëve: Kosova dhe Sanxhaku i Nishit iu dhanë Serbisë. Tetova, Shkupit, Kumanova dhe Manastiri iu dhanë Mbretërisë së Serbisë. Çamëria dhe një pjesë e madhe e Shqipërisë së Jugut iu dhanë Greqisë. Lugina e Preshevës mbeti nën sundimin serb, pavarësisht se shumica e popullsisë ishte shqiptare.

Shqiptarët kërkuar një rishikim të vendimeve, por fuqitë evropiane nuk reagues. Kjo padrejtësi vazhdon edhe sot, pasi shumë nga territoret e humbura ende nuk kanë fituar të drejtat e tyre.

1.3. Konferenca e Versajës (1919) - Shqipëria në Rrezik Zhdukjeje.

Pas Luftës së Parë Botërore, shtetet fqinje kërkuar ndarjen totale të Shqipërisë. Serbia, Greqia dhe Italia lobuan fuqishëm për ta fshirë Shqipërinë nga harta. Franca dhe Britania nuk e mbështetën ekzistencën e Shqipërisë, pasi kishin aleanca me Serbinë dhe Greqinë. Vetëm ShBA-ja, përmes presidentit Woodrow Wilson, bllokoi planin për copëtimin e Shqipërisë. Mësim historik: Pa ndërhyrjen e ShBA-së Shqipëria nuk do të ekzistonte sot si shtet. Evropa, edhe pse ishte përgjegjëse për problemin, nuk ndërmori hapa për ta zgjidhur atë.

2. A MUND EVROPA TA KORRIGJOJË BORXHIN HISTORIK PA SHBA-në?

Në teori, PO. Në praktikë, JO. Pse? Sepse Evropa është e ndarë në disa interesa të kundërta: Gjermania dhe Franca mbështesin integritetin e shqiptarëve, por nuk duan të

përplasen me Serbinë apo Rusinë. Greqia dhe Spanja janë kundër njohjes së Kosovës dhe kanë rezerva ndaj shqiptarëve në BE. Italia dhe Austria kanë qenë tradicionalisht mbështetëse të shqiptarëve, por ndikimi i tyre është i kufizuar. Serbia dhe Rusia llojnë fuqishëm për të penguar çështjen shqiptare në instancat ndërkombëtare. Kosova ende nuk njihet nga pesë shtete të BE-së (Spanja, Greqia, Rumania, Sllovakia, Qiproja), sepse Evropa nuk ka një qëndrim të unifikuar. Bashkimi Evropian nuk ka bërë presion serioz mbi Serbinë për të njohur Kosovën, përkundrazi, ka vazhduar dialogun me koncesione të shumta për Serbinë.

3. PA SHBA-NË, ÇFARË DO TË NDODHTE ME ÇËSHTJEN SHQIPTARE?

Nëse ShBA-ja nuk do të ishte e përfshirë, disa skenarë do të ishin shumë të mundshëm:
1. Pavarësia e Kosovës do të ishte e rrezikuar, pasi BE-ja nuk do të kishte ndërhyrë ushtarakisht më 1999 pa ShBA-në.
2. Kosova do të mbetej ende nën Serbi, sepse ShBA-ja ishte aktorja kryesore në shpalljen dhe mbrojtjen e pavarësisë.
3. Shqiptarët në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc do të përballeshin me diskriminim

edhe më të madh, pasi Evropa nuk ka ndërhyrë seriozisht për të mbrojtur të drejtat e tyre.
4. Serbia do të kishte avantazh në Ballkan, sepse Rusia do të ushtronte më shumë ndikim në rajon.

A MUNDET EVROPA PA SHBA-NË?

Përgjigjja është JO.

1. Evropa ka një borxh të madh historik ndaj shqiptarëve, por nuk ka treguar vullnet të mjaftueshëm për ta kthyer atë.
2. ShBA-ja ka qenë faktori kyç në mbrojtjen e interesave shqiptare në rajon.
3. Pa ShBA-në shqiptarët do të përballeshin me rrezikun e marginalizimit dhe ndarjes nga proceset euroatlantike.
4. Nëse shqiptarët duan të sigurojnë të drejtat e tyre historike dhe politike, ata duhet të mbajnë një aleancë të fortë me ShBA-në dhe ta shtojnë Evropën drejt veprimeve më konkrete. Strategjia më e mirë për shqiptarët: Ta forcojnë rolin e ShBA-së në rajon. Të llojnë fuqishëm në BE për t'i ndryshuar politikat e saj ndaj Kosovës dhe Shqipërisë. Të kërkojnë garanci të forta diplomatike dhe ushtarake nga aleatët perëndimorë. Pa ShBA-në, Evropa nuk ka treguar asnjëherë vullnet të qartë për të ndërmarrë padrejtësitë historike ndaj shqiptarëve.

Aktakuzë kundër katër personave, tentuan të transportonin dhe shisnin drogë nga Kosova në Shqipëri

Prizren, 3 shkurt - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve D. T., E. D., R. V. dhe P. S., të cilët gjenden nën masën e paraburgimit nga data 06.06.2024, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale "Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge". Në njoftimin e Prokurorisë thuhet se ata, sipas aktakuzës, më 05.06.2024, rreth orës 22:38, pa autorizim transportojnë me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes, sasi të konsiderueshme të narkotikëve, të cilët janë shpallur të ndaluara me ligj, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, në atë mënyrë që të akuzuarit vendosin narkotikët në

bagazhet e dy automjeteve VV Golf 7, dhe nisen në drejtim të kufirit Kosovë - Shqipëri për të shkuar në Shëngjin në festivalin "Unum". "Gjatë rrugës, pasi tejkalojnë shpejtësinë e lëvizjes, automjetit të parë që drejtohej nga E. D. i shqiptohet tiketa nga ana e policisë, dhe në ato momente i pandehuri D. T., që ishte në veturën e dytë, pasi kishte ndaluar veturën, shkon te vetura e parë, ku e tërheq një çantë krahu nga automjeti dhe e gjuan në një largësi rreth pesë metra, me ç'rast, pas shqiptimit të tiketave, i njëjti shkon në të njëjtin vend për ta marrë çantën me qëllim që ta vendosë në veturë, me ç'rast zyrtarët policorë reagojnë dhe gjatë kontrollimit të çantës vërejnë substanca të konsiderueshme narkotike të vendosura në qese të najlonit", ka njoftuar Prokuroria Themelore në Prizren.



Prishtina shpall gjendje të jashtëzakonshme për menaxhimin e mbeturinave

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 SHKURT - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme në lidhje me menaxhimin e mbeturinave në kryeqytet. Në një konferencë për medie mbajtur të hënën, ai ka thënë se kompania rajonale publike “Pastrimi”, e cila aktualisht është kompania e vetme e angazhuar për grumbullimin e mbeturinave në Prishtinë, nuk është treguar efikase në këtë detyrë. “Vendimi për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme bazohet në rezultatet e arritura gjatë vitit 2024 pas marrjes së masave emergjente për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave. Një ndër hapat kryesorë ishte përfshirja e operatorëve ekonomikë në zonën qendër dhe furnizimi i lokacioneve me kontejnerë të rinj, çka ndikoi në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe krijimin e një mjedisi më të pastër për qytetarët. Duke qenë se ndërmarrja ‘Pastrimi’ vazhdon të përballet me mungesë të mekanizmit të nevojshëm dhe nuk është në gjendje t’i përmbushë detyrimet kontraktuale, Drejtoria e Shërbimeve Publike ka siguruar mekanizëm shtesë për vitin 2025”, ka thënë Rama, duke

shtuar se konkretisht janë blerë kamionë të rinj për ndërmarrjen “Pastrimi” dhe 2 500 kontejnerë të rinj të cilët ende nuk janë shpërndarë pavarësisht prej kërkesave të vazhdueshme. “Po ashtu, është iniciuar procedura e prokurimit për angazhimin e pesë operatorëve privatë në grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, me synimin që ndarja e Prishtinës në gjashtë zona ta bëjë kryeqytetin ndër më të pastrit në rajon. Megjithatë, ndërkohë që po punohej për zbatimin e këtyre reformave, me iniciativën e asamblistit të PDK-së, Leotrim Retkoceri, dhe me mbështetjen e grupit të asamblistëve të Vetëvendosjes, u miratua ndryshimi i rregullores për menaxhimin e mbeturinave. Ky ndryshim i dha ndërmarrjes ‘Pastrimi’ të drejtën ekskluzive për këtë shërbim, duke përjashtuar operatorët privatë dhe duke krijuar një monopol që, siç ishte e qartë për propozuesit dhe votuesit e tij, do të çonte në kaos ambiental dhe në mungesë të shërbimit bazik për qytetarët”, ka theksuar Rama. Ai ka thënë se ditët e fundit ka pranuar ankesa të shumta nga qytetarët për mungesën e shërbimit me javë të tëra, veçanërisht në sistemin “derë më derë”. “Një ekip i krijuar



nga Drejtoria e Shërbimeve Publike ka inspektuar terrenin dhe ka konstatuar një situatë alarmante, me rrezik të madh përhapjeje epidemish. Për këto arsye, si institucion përgjegjës për mirëqenien e qytetarëve të kryeqytetit, jemi të detyruar ta shpallim sërish gjendjen e jashtëzakonshme. Ky hap është i domosdoshëm për t’i marrë masat e nevojshme që situata të vihet nën kontroll, duke garantuar pastërtinë dhe shërbimet bazë për qytetarët e Prishtinës”, ka deklaruar Rama. Petrit Reçica, kryeshef i kompanisë “Pastrimi”, ka

reaguar ndaj deklaratave të zyrtarëve komunalë, duke mohuar kritikën se kompania që e udhëheq nuk po e kryen punën si duhet. “Rama po manipulon me mbeturinat për t’ua dhënë tenderët miqve të tij! Deri sot në orën 9:00 të mëngjesit, Rama nuk na kishte dorëzuar as kamionët dhe kontejnerët e blerë, as dokumentet e tyre për regjistrim. Vetëm pak para konferencës, rreth orës 9, ai dorëzoi disa prej tyre, por jo të gjithë, pavarësisht kërkesave tona të vazhdueshme. Ky është një tjetër tregues i qartë i manovrave për të bllokuar shërbimet publike dhe për të

krijuar kaos të qëllimshëm. Më 07.01.2025, përmes një emaili drejtuar kryetarit Rama dhe z. Bekim Brestovci, kam kërkuar një takim për të koordinuar shërbimet e pastrimit në kryeqytet. U deshën më shumë se 10 ditë për një përgjigje, dhe në atë takim dukej i vendosur që pastrimin t’ua jepte kompanie private, duke treguar qartë mungesën e vullnetit për zgjidhje dhe synimin për ta politizuar këtë çështje. Për më tepër, Rama ka kërkuar nga disa punëtorë të ‘Pastrimit’ të sabotojnë shërbimin, vetëm që të krijojë kaos për të ja dhënë tenderin për grumbullimin e mbeturinave kompanisë private dhe të gjejë një arsye për shkarkimin tim (për të cilat kemi fakte të mjaftueshme)”, ka thënë Reçica. Ai ka theksuar se tani, si justifikim për këto dështime të qëllimshme, komuna ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme për menaxhimin e mbeturinave, duke pretenduar se “Pastrimi” nuk po e kryen punën si duhet. “Të nderuar qytetarë, ne po punojmë pa pushim 24 orë për 7 ditë të javës, me gjithë këto sfida, dhe nuk dorëzohemi me të vetmin qëllim që Prishtinën do ta pastrojmë nga mbeturinat”, ka thënë Reçica.

Varrosen tre të miturit që vdiqën pas shembjes së objektit në Jabllanicë



GJAKOVË, 3 SHKURT - Në Jabllanicë të Gjakovës u varrosën tre fëmijë që vdiqën më 1 shkurt si pasojë e shembjes së një objekti të vjetër. Në ceremoninë e varrimit morën pjesë qindra qytetarë, në mesin e tyre edhe shokë të shkollës të viktimave. Një nga shokët e klasës së dy viktimave, tha gjatë ceremonisë së varrimit

se lajmi për humbjen e shokëve i ka tronditur të gjithë pa masë, “duke lënë një boshllëk të madh në klasë e në jetën tonë”. Ndërkaq, kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, u shpreh se kjo ishte një ditë e rëndë për të gjithë. Sipas autoriteteve, objekti është shembur në rrethana ende të panjohura, ndërkaq tre djemtë, dy të moshës 15-vjeçare dhe

tjetri 13 vjeç, ishin brenda kur janë zënë nga pllaka. Nga policia kanë thënë se objekti i shembur ka qenë një ndërtesë e vjetër, e pabanuar, e mbetur pas luftës së vitit 1999 në Kosovë. Familjari i viktimave, Përparim Ademaj, tha për mediet lokale më 2 shkurt se të rinjtë kanë dalë disa orë para incidentit për të luajtur së bashku, ndërsa

familjarët e kanë zbuluar se ata kanë qenë në objektin e rrënuar nga dridhjet e telefonave, sa kanë qenë duke i kërkuar në rrethinë. Sipas tij, kamerat e shtëpive në afërsi tregojnë se objekti i pabanuar është shembur rreth orës 16:35 të shtunën, ndërsa trupat e viktimave janë gjetur pas gati gjashtë orëve. “Policia, ambulancat, zjarrfikësit kanë

ardhur shumë shpejt. I kemi gjetur pa shenja jete”, ka deklaruar Ademaj. Prokuroria e Shtetit ka njoftuar se ka nisur hetimet për këtë ngjarje, teksa figura politike, përfshirë presidenten, kryeministrin dhe kryeparlamentarin, kanë shprehur pikëllim për këtë ngjarje dhe kanë kërkuar që ai të zbardhet.



Platforma eKosova arrin një milion përdorues, hap i madh drejt transformimit digjital

PRISHTINË, 3 SHKURT - Platforma eKosova ka arritur në një milion përdorues, duke shënuar një moment kyç në transformimin digjital të Kosovës. Kjo është një dëshmi e besimit dhe mbështetjes së përdoruesve, të cilët kanë zgjedhur platformën eKosova për t'i shfrytëzuar shërbimet e saj moderne, të shpejta dhe efikase.

Përmes një njoftimi platforma eKosova ka theksuar se arritja e këtij suksesi është rezultat i përkushtimit dhe angazhimit për të ofruar një platformë që u përgjigjet nevojave të qytetarëve, duke ofruar mundësi të reja dhe inovative në sektorin e shërbimeve digjitale. Platforma është e angazhuar ta vazhdojë përmirësimin

dhe zgjerimin e shërbimeve të saj, duke ofruar mundësi të reja për qytetarët. "Jemi të përkushtuar që të vazhdojmë të punojmë për t'i përmirësuar dhe zgjeruar shërbimet tona, duke sjell më shumë mundësi dhe inovacion për ju. Faleminderit që jeni pjesë e këtij rrugëtimi! Bashkë ndërtojmë të ardhmen digjitale", thuhet në njoftim.



Tregu i përbashkët rajonal është një rrugë drejt një të ardhmeje më të mirë dhe më të sigurt

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

SARAJEVË, 3 SHKURT - Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Amer Kapetanović, ka mbajtur të hënën një leksion me titull "Plani i rritjes: duke ecur në bisedë - bashkëpunimi rajonal në veprim" në Fakultetin e Shkencave Politike në Sarajevë. Veprimtaria mbledhi profesorë universiteti, studentë, përfaqësues të institucioneve të Bosnjë-Hercegovinës, organizatave ndërkombëtare dhe trupit diplomatik, duke ndezur një diskutim dinamik mbi integrimin ekonomik rajonal, integrimin në BE dhe rolin e bashkëpunimit rajonal në forcimin e Ballkanit Perëndimor. Në prezantimin e tij, sekretari i përgjithshëm Kapetanović theksoi se bashkëpunimi rajonal nuk është më një opsion, por një domosdoshmëri për të ardhmen ekonomike të rajonit. "Ballkani Perëndimor ka dy zgjedhje: të rriten së bashku ose të luftojnë vetëm. 82 % e njerëzve në rajon besojnë në bashkëpunimin rajonal. Por sa shpesh e kthejmë besimin në veprim? Plani i Rritjes dhe pjesa integrale e tij, Tregu i Përbashkët Rajonal, janë shansi ynë për të bërë pikërisht këtë - ato ofrojnë mundësi të prekshme për bizneset, institucionet dhe, më e rëndësishmja, të rinjtë që e shohin të ardhmen e tyre në një Ballkan Perëndimor të begatë dhe të integruar ekonomikisht", tha Kapetanović. Kapetanović theksoi përfitimet reale të bashkëpunimit rajonal të arritur deri më tani, duke



përfshirë: dyfishimin e tregtisë ndër-rajonale, roaming në Ballkanin Perëndimor të lirë, çmime më të ulëta të roaming midis rajonit tonë dhe BE-së, korsitë e gjelbra që mundësojnë më pak kohë pritjeje në kufij dhe mundësojnë më shumë lëvizshmëri të fuqisë punëtore brenda rajoni. Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor, i paraqitur nga Komisioni Evropian, i ofron rajonit një derë të hapur për të hyrë në tregun e vetëm të BE-së, investime të reja dhe mundësi punësimi. Megjithatë, siç theksoi Kapetanović, këto përfitime janë të kushtëzuara: "BE-ja ka qenë e qartë, nëse

duam të përfitojmë nga Plani i Rritjes, së pari duhet ta realizojmë integrimin ekonomik rajonal dhe agjendat e reformave të brendshme. Tregu i Përbashkët Rajonal nuk është thjesht një politikë. Është një rrugë drejt një të ardhmeje më të mirë dhe më të sigurt. Nëse zbatohet plotësisht, mund ta rrisë PBB-në tonë me 10 %". Ai bëri thirrje për reforma urgjente, duke vënë në dukje se BE do të ndajë 6 miliardë euro financime vetëm për ekonominë që tregojnë përparim në qeverisje, financat publike dhe shtetin e së drejtës. "Disa ekonomi të Ballkanit Perëndimor kanë dorëzuar

tashmë agjendat e tyre të reformave dhe janë vendosur të marrin parafinancim. Fatkeqësisht, Bosnjë-Hercegovina nuk e ka finalizuar agjendën e saj të reformave, duke na vënë në rrezik për ta humbur qasjen në këto fonde kritike. Ne nuk mund të lejojmë ta humbasim këtë mundësi", paralajmëroi ai. Kapetanović, gjithashtu, theksoi se RCC nuk është e fokusuar vetëm në Ballkanin Perëndimor, por luan një rol më të gjerë në Evropën Juglindore (EJL), duke vepruar si një krah operacional i Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) me 13

pjesëmarrës, duke përfshirë pesë shtetet anëtare të BE-së. Ai theksoi rolin koordinues të RCC në Strategjinë EKL 2030, e cila përputhet me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së dhe synon t'i trajtojë sfidat kryesore rajonale si ulja e varfërisë, shpopullimi dhe gatishmëria ndaj fatkeqësive. "Puna jonë shtrihet përtej rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ne jemi një krah operacional i qeverive të EJL-së, duke mbështetur rritjen e qëndrueshme ekonomike, transformimin e gjelbër dhe digjital, dhe duke reduktuar pabarazitë sociale dhe ekonomike me BE-në". Pas fjalimit, dekani i fakultetit Sead Turcalo moderoi një sesion të gjallë pyetje dhe përgjigje, duke lejuar studentët dhe ekspertët të angazhohen drejtpërdrejt me sekretarin e përgjithshëm Kapetanović për çështje që variojnë nga reformat ekonomike deri te siguria rajonale. Kapetanović e mbylli me një mesazh për të ardhmen: "Bashkëpunimi rajonal nuk ka të bëjë me politikën, institucionet apo burokracinë - ka të bëjë me njerëzit. Ka të bëjë me sigurimin që pesë, dhjetë vjet nga tani, ne të gjithë të kemi më shumë mundësi, punë më të mira dhe një rrugë më të lehtë drejt suksesit pikërisht këtu në rajonin tonë. Kjo e ardhme është e arritshme, por vetëm nëse zgjedhim ta ndërtojmë së bashku". RCC mbetet e përkushtuar për të çuar përpara bashkëpunimin rajonal dhe për të siguruar që Ballkani Perëndimor dhe Evropa Juglindore të ecin së bashku drejt një të ardhmeje më të fortë dhe më të lidhur.

Murati: Sivjet do të faturuhet edhe tatimi në pronë për katër komunat veriore të vendit

Prishtinë, 3 shkurt - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë që këtë vit do të faturuhet edhe tatimi në pronë për katër komunat

veriore të vendit. Sipas Muratit, kjo po ndodh për herë të parë pas 25 vitesh. "Pas faturave të energjisë elektrike, sivjet do të

faturuhet edhe tatimi në pronë për katër komunat veriore të vendit. Për herë të parë pas 25 vitesh", ka shkruar ministri. Ai ka thënë:

"Falënderoj stafin e MFPT si dhe stafin e komunave përkatëse për punën e palodhshme për realizimin e kësaj arritjeje".



Nga Washingtoni në Evropë, Elon Musk po zgjat duart kudo



MEGA (Make Europe Great Again), një iniciativë e ngjashme me filozofinë e Trump për “America First”, e cila synon të përhapë politikat e trumpizmit në Evropë, duke forcuar lëvizjet populiste dhe nacionaliste në disa vende të kontinentit. Dhe përplasja me administratën amerikane për kontrollin e 5 mijë miliard dollarëve...

Elon Musk ka marrë një rol të ri të jashtëzakonshëm në administratën e Donald Trump, duke u vendosur në krye të Ministrisë së Efiçencës Shtetërore (DOGE – Department of Government Efficiency), një njësi e re që synon të rishikojë dhe të ulë shpenzimet publike. Ky institucion, që nuk ka një buxhet të vetin dhe funksionon më shumë si një task force, ka marrë një pushtet të jashtëzakonshëm: qasje në sistemin e pagesave të Thesarit Amerikan, që kontrollon rreth 5 mijë miliardë dollarë pagesa federale çdo vit.

Musk dhe Mega: Një thirrje për Evropën

Përveç rolit të tij në financat federale të SHBA-së, Musk ka rforcuar edhe përfshirjen e tij në politikën globale duke promovuar “Make Europe Great

Again” (MEGA), një iniciativë e ngjashme me filozofinë e Trump për “America First”. Kjo nismë synon të përhapë politikat e trumpizmit në Evropë, duke forcuar lëvizjet populiste dhe nacionaliste në disa vende të kontinentit.

Musk ka ndërhyrë më parë në çështje politike evropiane, përfshirë debatet mbi politikën energjetike, censurën dhe emigracionin, dhe tani po shfrytëzon ndikimin e tij për të promovuar një vizion të ri për Evropën, të bazuar në më shumë sovranitet ekonomik dhe më pak ndërhyrje shtetërore.

Një hap i rrezikshëm?

Departamenti i Thesarit të SHBA-së është sistemi përmes të cilit kalojnë pagesat e pensione, interesat e borxhit shtetëror, fondet për administratat lokale dhe pagesat për furnizuesit e qeverisë.

Administrata Trump ka deklaruar se DOGE do të ketë akses vetëm për lexim, duke mos pasur kompetenca për të ndaluar ose vonuar pagesat. Sidoqoftë, Musk ka lënë të kuptohet se mund të ndërhyjë në mënyrë aktive. Në një postim në platformën e tij X (ish-Twitter), ai shkroi se ekipi i tij kishte zbuluar urdhra për të vazhduar pagesat edhe ndaj organizatave terroriste dhe subjekteve të përfshira në mashtrime.

Ky pohim ka ngritur shqetësime serioze se DOGE mund të përdoret për ndërhyrje politike ose financiare, duke ndaluar pagesa të caktuara apo duke favorizuar sektorë të ndryshëm sipas interesave të Musk apo administratës Trump.

Përplasje me burokracinë amerikane

Lëvizja e fundit e Musk e vendos

atë në një përplasje të drejtpërdrejtë me strukturat tradicionale të administratës publike. Ndërsa teknokratët dhe burokratët mbrojnë procedurat ekzistuese, Musk vjen nga një botë ku ndryshimi radikal dhe inovacioni janë thelbësore. Ai është një “disruptor”, një figurë që beson në shkatërrimin e modeleve të vjetra për të krijuar diçka të re.

Një shembull i qartë është përplasja e tij e mëparshme me NASA-n, ku SpaceX arriti të sfidonte dhe më në fund të zëvendësonte Boeing si partnerin kryesor të agjencisë për misionet hapësinore. Boeing kishte përfituar nga kontrata të fryra dhe burokraci të ngadalta, por përfundimisht NASA iu drejtua Musk për të ofruar zgjidhje më të lira dhe më efikase.

Fillimi i një revolucioni administrativ?

Musk e sheh DOGE si një mundësi për të “pastruar” qeverinë nga burokracia dhe shpërdorimi i fondeve publike, duke e trajtuar atë si një kompani të madhe në krizë, që ka nevojë për një reformë rrënjësore. Ai beson se

pandemia e COVID-19 zbuloi dështimet e administratës amerikane, pasi miliarda dollarë u shpërdoruan për pagesa mashtruese përmes ndihmave emergjente.

Por kritikët e shohin këtë lëvizje si një rrezik të madh për demokracinë dhe sistemin ekonomik të SHBA-së. Ata paralajmërojnë se Musk nuk është një figurë e zgjedhur politikisht, por një sipërmarrës me interesa personale, dhe kontrolli i tij mbi 5 mijë miliardë dollarë fonde publike mund të hapë rrugën për abuzime të paprecedenta.

Me Elon Musk në krye të një prej sistemeve më të rëndësishme financiare të SHBA-së, bota po shikon me vëmendje se çfarë do të ndodhë më tej. A është ky fillimi i një epoke të efiçencës dhe reduktimit të shpërdorimeve publike, apo një hap drejt një centralizimi të rrezikshëm të pushtetit ekonomik në duart e një individi të vetëm?

Një gjë është e sigurt: Elon Musk nuk është më vetëm një sipërmarrës i teknologjisë, por një nga figurat më me ndikim në politikën dhe ekonominë globale. / **bota.al**



SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Montim
Servisim
Perdorim



Dukagjini paraqet djalin e Igli Tares

Pas paraqitjeve të mira dhe golave të shënuara në fazën përgatitore në Antalia të Turqisë, Dukagjini ka paraqitur sulmuesin e ri, Etienne Tare. Në katër ndeshje miqësore të Dukagjinit në Turqi, sulmuesi Tare ka realizuar dy gola. Në njoftimin e Dukagjinit thuhet se Tare do të jetë përforcim i rëndësishëm për klubin në pjesën pranverore të Superligës së Kosovës në futboll. Tare i është bashkuar Dukagjinit nga Skënderbeu i Korçës, kurse ka luajtur edhe për të rinjtë e dy klubeve të mëdha nga Austria, Rapid dhe Sturm Graz. Etienne 21-vjeçar është i biri i ish-sulmuesit të Kombëtares së Shqipërisë, Igli Tare, kurse karrierën e ka nisur në akademinë e klubit të njohur nga Italia, Lazio.

Tervell Beck, MVP i javës në Superligën e basketbollit

PRISHTINË, 3 SHKURT - Proton Cable Prizreni shënoi fitore shumë të rëndësishme ndaj Borës. Më i miri i kësaj sfide ishte ish-basketbollisti i Pejës, Tervell Beck. Ai ndaj skuadrës prishtinase kishte 30 pikë, 12 kërcime, pesë asistime, pesë topa të vjedhur dhe një bllokadë. Beck kishte indeksin 43 apo më të lartin e kësaj xhiro, duke u shpallur edhe MVP. Ndeshje shumë të mirë kishte edhe Jordan Johnsoni me 31 pikë, pesë kërcime e katër asistime. Sigal Prishtina fitoi ndaj Bashkimit në Prizren, ku sërish qendra Rashid Mahalbashiq udhëhoqi bardhekaltrit. Ai e mbylli ndeshjen me 11 pikë, 13 kërcime dhe gjashtë asistime. Vëllaznimi fitoi ndaj Golden Eagle Yllit, ku te kuqezinjtë më i dalluari ishte Arian Azemi me 24 pikë, gjashtë kërcime dhe pesë asistime. Trepça triumfoi në derbin ndaj Pejës, ku më i miri ishte Mikaile Tmusiq me 17 pikë, katër kërcime dhe tri asistime.

MVP

Tervell Beck (Proton Cable Prizreni) 30 pikë, 12 kërcime, 5 asistime, 43 indeksi

Top 5

Tervell Beck (Proton Cable Prizreni) 30 pikë, 12 kërcime,



5 asistime, 43 indeksi
Jordan Johnson (Proton Cable Prizreni) 31 pikë, 5 kërcime, 4 asistime, 31 indeksi
Rashid Mahalbashiq (Sigal Prishtina) 11 pikë, 13 kërcime, 6 asistime, 26

indeksi
Arian Azemi (Vëllaznimi) 24 pikë, 6 kërcime, 5 asistime, 25 indeksi
Mikaile Tmusiq (Trepça) 17 pikë, 4 kërcime, 3 asistime, 17 indeksi

SHKURT

Vojvoda nga Torino do të transferohet te Como

Mërgim Vojvoda do të largohet nga Torino dhe do të transferohet te Como. Mbrojtësi shqiptar pritet të firmosë me Comon, kërkesë kjo e trajnerit Cesc Fabregas. “Nënshkrimi i marrëveshjes është planifikuar për nesër në mëngjes. Pra të hënën më 3 shkurt”, shkruan eksperti i merkatos, italianii Gianluca Di Marzio. Bëhet me dije se Vojvoda do nënshkruajë deri në vitin 2027.

KF Ramiz Sadiku me sukses përmbyll fazën përgatitore në Durrës

Skuadra e KF Ramiz Sadiku ka përmbyllur me sukses fazën përgatitore në Durrës, ku për disa ditë zhvilloi seanca intensive stërvitore dhe ndeshje miqësore në kuadër të përgatitjeve për sezonin e ri. Përveç stërvitjeve të përditshme, KF Ramiz Sadiku zhvilloi edhe dy ndeshje miqësore, të cilat shërbyen si test i rëndësishëm për vlerësimin e formës së lojtarëve dhe implementimin e skemave taktike. “Pas një faze të suksesshme përgatitore, skuadra tani rikthehet në Kosovë me synime të qarta për sezonin e ri, duke synuar rezultate pozitive dhe paraqitje të denjë në kampionat”, thuhet në njoftimin e skuadrës prishtinase.

Galatasaray synon transferimin e Ismajlit

Pas transferimit të Alvaro Moratas, gjiganti turk Galatasaray synon ta transferojë edhe mbrojtësin shqiptar të Empolit, Ardian Ismajlin. Reprezentuesi i Shqipërisë me skuadrën italiane ka kontratë deri në fund të këtij sezoni por, sipas medieve të huaja, Ismajli mund të jetë protagonist i një transferimi të minutës së fundit. Mbrojtësi shqiptar prej kohësh është cak i Napolit dhe Juvetusit mirëpo, siç raportohet, lojtari mund të bëhet pjesë e klubit më të madh në Turqi. Krerët e Galatasarayt thuhet se shumë shpejt do ta dërgojnë ofertën tek Empoli për Ismajlin.

Gërbeshi largohet nga Vushtrria

Mbrojtësi Fidan Gërbeshi nuk do të jetë më lojtar i skuadrës së Vushtrrisë. Lajmin për largimin e Gërbeshit e ka e ka konfirmuar skuadra e Ligës së Parë. “FC Vushtrria njofton se, me marrëveshje të dyanshme, është ndërprerë bashkëpunimi me qendërmbrojtësin Fidan Gërbeshi. Klubi e falënderon për kontributin e dhënë gjatë periudhës që ishte pjesë e ekipit dhe i uron suksese të mëtejshme në hapat e radhës të karrierës”, thuhet në njoftimin e klubit vushtrrias.

Gjyqtarët marrin stemën e FIFA-s

PRISHTINË, 3 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës ka organizuar ceremoninë e ndarjes së stemave të FIFA-s për gjyqtarët meshkuj dhe femra për vitin 2025. Të pranishëm në këtë ceremoni, pos gjyqtarëve dhe asistentëve, ishin edhe presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe kryetari i

Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës, Përparim Hasani. I pari i FFK-së vlerësoi punën e gjyqtarëve si në kampionatin vendor ashtu edhe në arenën ndërkombëtare dhe kërkoi nga ata ta vazhdojnë punën e tyre me përkushtim dhe vëmendje të shtuar. Gjyqtarët kryesorë: Visar Kastrati, Genc Nuza, Mervan

Bejtullahu, Rita Vehapi. Asistentët: Fatlum Berisha, Bujar Selimaj, Besnik Morina, Lumturije Muhadri, Edmond Zeqiri, Fatlum Sekiraqa, Granit Hyseni, Arbnor Bullatovci, Fitore Govori. Video Match (VAR): Genc Nuza, Visar Kastrati. Gjyqtarët e futballit: Florentina Kallaba, Besar Beqiri, Besart Ismajli.



Trajneri i Liverpoolit: Nuk mund të kërkoj asgjë më shumë nga ky ekip

LIVERPOOLI, 3 SHKURT - Liverpooli fitoi 2-0 në shtëpinë e Bournemouthit falë dy golave të Mohamed Salahut dhe ruajtje epërsinë prej gjashtë pikësh ndaj Arsenalit në renditjen e Premierë Ligës, me një ndeshje më pak. Gjithsesi, për trajnerin e “Reds”-it Arne Slot fitorja nuk ishte aspak e lehtë dhe u desh një

kampion si Salah që t’i jepte fitoren. “Ishte ndeshja që prisnim. Ata janë intensivë, vazhdojnë të vrapojnë dhe të luftojnë çdo sekondë. Ne duhej të jepnim përtej mundësive tona për të fituar dhe pranoj se këtë herë fituam edhe me pak fat. Na duhej fat për të fituar këtë takim”, ka thënë trajneri holandez. “Patëm fat pasi

ata goditën shtyllën dy herë dhe vazhdimisht përpiqeshin të shënonin. Ata kishin edhe shanse të tjera dhe nuk mendoj se e kontrolloam lojën. Ishte një lojë e hapur dhe e barabartë, sepse të gjitha ekipet luftojnë këtu në Premierë”, ka shtuar Slot. “Goli i dytë ishte diferenca mes dy skuadrave. Nuk ishte një rast

i lehtë apo i thjeshtë. Mënyra se si Salah shënon është kaq e lehtë për të. Kjo tregon se sa cilësi ka ai për të fituar një ndeshje si kjo. Pjesa tjetër e ekipit dhe ai punuan shumë për ta mbajtur portën e pastër. Nuk mendoj se mund të kisha kërkuar më shumë se ku jemi në këtë moment”, ka deklaruar Slot.



Russell: Me Kimi Antonellin jemi dyshe interesante

STUTTGART, 3 SHKURT - Te Mercedesi presin një vit të vështirë pas largimit të Lewis Hamiltonit për te Ferrari. Vendin e shtatë herë kampionit të botës në Formula 1 e zuri 17-vjeçari italian Kimi Antonelli, ndaj ky pritet të jetë një vit tranzicioni te skuadra gjermane. Britanikut George Russell i skadon kontrata në fund të këtij viti. E nga viti 2026 do të nisë një epokë e re, me rregulla e makina të reja, ndaj ky vit do të jetë thelbësor për të dy pilotët. “Vendin e Lewisit nuk e zë dot asnjë pilot në qarkullim, por unë dhe Kimi do të mundohemi të mbajmë Mercedesin në vendin që i takon. Shpresoj që përvoja e këtyre viteve të më ndihmojë mua dhe atë”, ka thënë Russell. “E njoh rolin tim të pilotit më me përvojë dhe kjo të bën të kuptosh që nuk je më një i ri. Unë jam duke hyrë në një kapitull të ri në karrierën time. Po mbaroj fillimin dhe po hyj në fazën e mesme. Lewisi ishte



29 vjeç kur iu bashkua Mercedesit dhe filloi t’i fitonte të gjitha kampionatet, ndërsa Michael Schumacher ishte 30 vjeç te Ferrari. Në ditët e sotme të gjithë fillojnë gjithnjë e më të rinj”, ka shtuar Russell. Më tej, britaniku ka thënë: “Kam debutuar në moshën 20-vjeçare, por tani ndihem gati të marr përgjegjësi brenda ekipit.

Gjëja më e rëndësishme është të ngasësh sa më shpejt që të jetë e mundur dhe ndihem në një pozicion të mirë për ta bërë këtë. Do të vazhdoj të mësoj, të jem i hapur dhe të mos marr asgjë si të mirëqenë. Ju ose keni shpejtësi ose nuk keni, por nuk ka dyshim se djemtë që vijnë do të jenë konkurrues”.

Clevelandi mposht Dallasin, kampionët e Bostonit triumfojnë ndaj Philadelphias

OHIO, 3 SHKURT - Cleveland arriti një fitore të lehtë ndaj Dallasit me rezultatin 144-101, ndeshje ku për teksanët u ndje mungesa e Doniqit, që tashmë është një lojtar i lakersave. Tetë basketbollistë të Cavaliersit realizuan mbi 10 pikë, ku më i miri ishte Sam Merrill me 27 pikë. Fitoi edhe skuadra e Bostonit, që mundi me shifrat 118-110 Philadelphian. Kampionët e



Celticsit bënë një ndeshje të mirë, ku u dallua Jayson Tatum me 35 pikë e 11 asistime. Skuadra e Detroitit, falë 43 pikëve të dyshes Duren - Cunningham, mundi me rezultat 127-119

REZULTATET	
Detroit - Chicago	127-119
Toronto - Clippers	115-108
Cleveland - Dallas	144-101
Philadelphia - Boston	110-118

rivalët e Chicagos. Zhgënjeu Milwaukee, që në fushën e vet u mund me rezultat 132-119 nga Memphis. Jaren Jacksoni me 37 pikë ishte shënuesi më i mirë për miqtë, ndërsa 30 pikët e Antotekounmpos mbetën për statistikë. Fitoi edhe Toronto, 115-108 ndaj clippersave, ndeshje ku u dallua RJ Barrett me 20 pikë.

SHKURT

Todt flet për Schumacherin: E takoj rregullisht, është pjesë e familjes sime

Jean Todt, një nga drejtuesit legjendarë të Formulës 1, që shkroi historinë e këtij sporti bashkë me Michael Schumacherin, ka folur për mediet në lidhje me gjendjen e shtatë herë kampionit të botës. “Familja e tij ka vendosur që ta mbajë këtë çështje sekrete, të mos u përgjigjet asnjë pyetje dhe unë e respektoj këtë vendim. Mund të them se e takoj rregullisht, me dashuri si atë ashtu dhe njerëzit pranë tij”, ka thënë Todt. Më tej, Todt, që ishte edhe president i FIA-s, shtoi: “Lidhja jonë shkon përtej asaj që arritëm në pistë, përtej punës së përditshme. Ai është pjesë e familjes sime që sot është shumë larg Formulës 1”.

Ramosi fillon një aventurë të re në Meksikë

Legjenda e Real Madridit dhe futbollit spanjoll, Sergio Ramos, tashmë është konfirmuar se do t’i rikthehet sërish futbollit. Kjo vjen pas konfirmimit se ai është pajtuar me kushtet e një kontrate me klubin meksikan Rayados. Ramos nuk ka luajtur në ndonjë ndeshje zyrtare që prej sezonit të kaluar, pasi i skadoi kontrata me Sevillën. 38-vjeçari si një profesionist i vërtetë, ndonëse ishte pa ekip, u sigurua që të qëndronte në formë optimale fizike. Sipas një raportimi të fundit nga eksperti i transferimeve Fabrizio Romano, mbrojtësi ka hedhur firmën për Rayados. “Sergio Ramos te Rayados! Para-kontrata u nënshkrua sot. Ai pritet të udhëtojë në Meksikë për hapat e ardhshëm”, ka shkruar Romano. Një njoftim zyrtar nga ana e klubit meksikan pritet që të vijë gjatë orëve në vazhdim.

Ronaldo: Nuk kam pasur marrëdhënie të këqija me Messin, rekordet tona vështirë të arrihen

Cristiano Ronaldo, rivali i tij më i madh në historinë e thujse dy dekadave futboll në Evropë, nuk heziton ta përmendë emrin Leo Messit. Që të dy së bashku kanë fituar kampionate në Spanjë, Angli, Itali dhe Francë, teksa kanë fituar edhe me kombëtaret përkatëse, me Ronaldon që u shpall fitues i Kampionatit Evropian, ndërsa Messi i Kupës së Amerikës Latine dhe Botërorit. Në një intervistë për “La Sexta”, Ronaldo sqaroi se ai asnjëherë nuk ka pasur probleme me Messin, pavarësisht prej debateve të shumta nga tifozët e të dyve. “Unë kurrë nuk kam pasur një marrëdhënie të keqe me Messin, përkundrazi”, ka thënë Ronaldo. Kur u pyet nëse bota do të shohë ndonjëherë ndonjë lojtar profesionist që arrin shifrat e Messit dhe Ronaldos, portugezi tha se kjo është pak e mundur. “Shpresoj që po, do të ishte e mirë për futbollin, por mendoj se ka pak gjasa”, ka përfunduar Ronaldo.

City pësoi debakël nga Arsenali, Guardiola: Luajtëm shumë mirë

Pas humbjes 5-1 nga Arsenali, trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ka habitur me deklaratën për mediet, duke thënë se ekipi i tij luajti shumë mirë. “Unë kam keqardhje vetëm

për 25 minutat e fundit. Ne harruam çfarë duhet të bëjmë, atë që kemi bërë për 60-70 minuta. Padyshim është një ndeshje e vështirë në këtë stadium ndaj kësaj skuadre në minutat e parë

ka ndodhur shumë herë në këto sezone. Por pas 10-15 minutash mendoj se morëm kontrollin e lojës dhe luajtëm shumë, shumë, shumë mirë dhe ishim në lojë pas 1-1 teksa kishim momentin e

mirë që të bënim tranzicionin dhe një devijim për golin e tretë. Duhet ta kapërcejmë këtë situatë. Nuk mund ta humbësh kontrollin. Janë 90-95 minuta. Nuk mund të përfundosh në

mënyrën se si luajtëm. Ne mund të kishim shënuar edhe tre gola të tjerë, por skuadra duhet të jetë e qëndrueshme, nuk ka rëndësi se çfarë ndodhi”, ka thënë Guardiola.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



KOMPANIA REJIONALE E MBETURINAVE
"Ambienti" SH.A PEJË
NR. 192
DATA 31.01.25

Kompania Rejionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës; LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MPPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Rejionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 03.02.2025, shpall konkurs të brendshëm për këto vende të punës :

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita : Kryepunëtor i terrenit - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës : 2.3

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Organizon dhe koordinon punën e punëtorëve në ndrrime, cakton punëtorët dhe automjetet në kryerjen e punës së përditëshme operative në itinerarin e caktuar;
- Mban evidencë për çdo punëtor për itinerarin e tij dhe kryen llogarinë e efektit të punës për çdo punëtor;
- Përcjell planin ditor dhe mujor të punës në bazë të planit operativ;
- Përcjell dhe kontrollon shfrytëzimin e kohës së punës për çdo punëtor, i evidenton dhe raportin e dorëzon në administratë dhe operativë, si dhe ditarin e punëve të kryera ia dorëzon menaxherit operativ;
- Kontrollon realizimin e detyrave ditore të punëtorëve në terren;
- Të gjitha problemet në terren është i obliguar t'i parashtrijë me kohë të udhëheqësi i sektorit;
- Drejtëpërdrejt kontrollon kualitetin e punës në terren dhe ua tërheq vrejijen punëtorëve që gjatë kryerjes së punëve të mos i dëmtojnë automjetet;
- Është përgjegjës për rregullsinë teknike dhe pastërtinë e automjetit;
- Kërkon nga vozitësit e automjeteve që në terren të sillen korrekt dhe të ndalen për grumbullimin e hedhurinave në vende të përshtatshme ku nuk pengohet komunikacioni dhe lëvizja e qytetarëve.
- Është përgjegjës për përdorimin e mjeteve mbrojtëse në punë.
- Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Menaxherit të Operativës, Kordinatorit Operativ;
- Për mos respektimin e pikave të lartecelura i përgjigjet drjtëpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta :(Kualifikimet profesionale)

- Shkolla e mesme;
- 1vite përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmbientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 03.02.2025 deri me 18.02.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Alma Beka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Fjolla Zeka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të II dhe III të Gjimnazit "Xhelal Hajda- Toni".

- Kleon Zariqit shpall të pavlefshme dëftesën e notave nga kl. I -V të, të shkollës "Ismail Qemali" Prishtinë.

- Neshet Kerleshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Magbule Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari".

- Florije Thaqi nga Rahoveci shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Gani Caverbasha".

- Atdhe Mustafa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Kadri Kusari" .

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar,

lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

